



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.11.2019, 10.30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe”

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Ralf Gjoni, Elona Gjebrea, Andrea Marto, Ervin Bushati, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Ditmir Bushati, Evis Kushi, Eglandina Gjermani, Vasilika Hysi, Rudina Hajdari, Ligoraq Karamelo, Vasil Sterjovski, Reme Lala dhe Ediola Braha.

Mungojnë: Fatmir Velaj, Halit Valteri,

Të ftuar:

Blendi Klosi - Ministër i Turizmit dhe Mjedisit

Zamir Dedej - Drejtor i Agjensisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita të gjithëve!

Ndërkohë që presim ministrin Klosi të vijë, për të shkurtuar kohën e qëndrimit në komision, meqenëse presim të vijë edhe legjislacioni, fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme të datës 11.11.2019.

Sot në rend të ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relatore e këtij projektligji është zonja Evis Kushi.

Ndërkohë, e ftoj ministrin Klosi të flasë për rëndësinë e projektligjit, përfitimet që Shqipëria do të ketë, si dhe për kostot finansiare, sepse ka disa, pavarësisht se janë të pakonsiderueshme.

Zoti Ministër, fjala për ju.

Blendi Klosi – Kjo konventë është shumë e rëndësishme në sensin e qenies bashkë në një tryezë, ku diskutohen problematikat e Detit Mesdhe. Pa dyshim është një nga konventat më të vjetra të Detit Mesdhe, mbi 110-vjeçare, dhe vendi ynë është i fundit që po aderon. Në kuadër të turizmit të detit që do të ofrojmë, është shumë e rëndësishme të jemi pjesë e tryezave, ku diskutohen këto problematika. Kjo tryezë është më shumë se europiane, sepse aty bëjnë pjesë të gjitha vendet e Afrikës Veriore dhe për këtë do të kemi mundësi të kuptojmë më shumë se çfarë ndodh.

Shqipëria ka rreth një vit që kërkon të aderohet në këtë konventë. Janë bërë të gjitha diskutimet me princit e Monakos gjatë vizitës së tij në Shqipëri, si dhe me titullarët e lartë të institucionit shtetëror në Monako, të cilët kanë rënë dakord që edhe Shqipëria të jetë pjesë e kësaj konvente. Kjo ka një kosto financiare, që do të mbulohet nga buxheti i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për vitin e ardhshëm në vlerën 25 mijë euro. Ne tashmë kemi filluar të përfitojmë nga konventa më shumë se sa kostoja që ne paguajmë. Kanë përfituar Agjencia e Zonave të Mbrojtura për Parkun Kombëtar Detar “Karaburun-Sazan” për sa i përket studimeve të kësaj fushe dhe disa LGO ku më kryesorja është shoqata “Pisha Flamur” në zonën e Llogorasë, e cila ka marrë disa projekte mbrojtëse nga pikëpamja mjedisore për vlerat që ka ajo zonë.

Mimi Kodheli - Faleminderit, zoti Ministër!

Në mungesë të relatores Kushi, kush ka pyetje, diskutime apo ndonjë paqartësi lidhur me projektligjin.

(Diskutime pa mikrofon)

Andrea Marto – E falënderoj ministrin për prezantimin!

Edhe unë jam i mendimit se kjo marrëveshje është e rëndësishme. Problemet që kemi ne me detin janë të mprehta, siç është problemi i madh i ndotjes, gjithashtu, kemi edhe ndikimin që sjellin në vijën bregdetare ndryshimet klimatike. Ne shikojmë se në vijën bregdetare duhen bërë punime, studime, në mënyrë që ta mirëmbajmë dhe të mos e dëmtojmë tokën bujqësore apo edhe ndërtimet që janë në bregdet. Problemi që kemi ne në Shqipëri, për këtë dua t'i tërheq vëmendjen ministrit, është se nuk kemi një institucion që të merret me studime oqeanografike apo detare. Pra, ne nuk kemi asnjë institucion të specializuar, ndaj do ta kemi shumë të vështirë për të thithur fonde që do të na krijonin më parë mundësinë e aderimit në këtë konventë.

(Diskutime pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Zonja Hajdari, fjala për ju.

Rudina Hajdari – Zoti Ministër, unë kam disa pyetje, sepse nuk jam e qartë. Së pari, a jemi ne komisioni përgjegjës?

Mimi Kodheli – Jo, ne jemi komision për dhënie mendimi.

Rudina Hajdari – Meqenëse jemi thjesht komision për dhënie mendimi, a mund të na thoni se çfarë sjell konkretisht ky projektligj për ne? Çfarë do të mbulohet me këtë vlerë që do të paguajmë? Pse vendi ynë është i fundit që aderon në këtë konventë, meqenëse thoni se ka ekzistuar që në vitin 1910? Pse po aderojmë pikërisht tani?

Pra, unë nuk jam shumë e qartë për disa gjëra: cili është qëllimi i këtij aderimi në këtë eksplorim shkencor?

Mimi Kodheli – A mund të bëj edhe unë një pyetje?

Blendi Klosi – Po, patjetër!

Mimi Kodheli – Fqinjët tanë kanë pasur probleme në brigjet e tyre, duke filluar nga bregdeti Dalmat deri në bregdetin Malazet nga hedhurinat që dërgon deti nga bregdeti shqiptar. A ndihmon aderimi në këtë strukturë për përgatitjen e projekteve dhe thithjen e parave, që të mundësojë eliminimin e këtij fenomeni, i cili shqetëson jo vetëm mjedisin shqiptar, por edhe mjedisin e vendeve fqinje?

Ditmir Bushati – A mund ta marr edhe unë fjalën?

Mimi Kodheli - Po, zoti Bushati.

Ditmir Bushati – Zoti Ministër, shumë faleminderit !

Nga mënyra se si jeni ulur duket sikur Deti Mesdhe e shtrin efektin deri në Skrapar. Pyetja që unë kam për ju është: sa është në përputhje anëtarësia e vendit tonë, nëpërmjet kësaj

konvente, me devizën që ju keni shpallur së fundi në të gjithë Shqipërinë, që Shqipëria nuk është e ndotur, por është e papastër? Çfarë duhet të bëjmë ne në këtë drejtim?

Faleminderit!

Blendi Klosi – Faleminderit, të nderuar kolegë, për të gjitha pyetjet që më drejtuat!

Unë ju ftoj që pas këtij takimi të bëheni pjesë e një tjetër takimi shumë të rëndësishëm të drejtuar nga ambasadori Soreka për sa i përket mbështetjes që do të japin vendet e Bashkimit Europian për reformat në fushën e mjedisit, sepse, në fund të fundit, aty mund të gjeni edhe disa nga përgjigjet e pyetjeve tuaja, sidomos për pyetjen e zonjës drejtuese të komisionit, që ka të bëjë me fonde të vërteta që bëjnë ndërhyrje të plota për të ndryshuar infrastrukturën.

Si fillim, po i përgjigjem zonjës Hajdari.

Shumë faleminderit, kolege, për shqetësimin tuaj! Në fakt, ky ka qenë edhe shqetësimi ynë nëse është e nevojshme të jemi pjesë e diskutimeve dhe projekteve, në mënyrë që kjo të justifikojë koston që ka në buxhetin e shtetit, paçka se kjo kosto është më e ulët, në krahasim me vendet e tjera, që janë pjesë e kësaj konvente. Ne kemi shumë ekspertë të fushës, siç e tha edhe zoti Marto, të cilët nuk janë më pjesë e strukturave të organizuara kërkimore-shkencore. Qenia pjesë e kësaj tryeze do të na ndihmojë të bëhemi pjesë e diskutimeve teknike për çfarë ndodh në zonën tonë.

Siç e thashë, vendet themeluese të konventës janë nga viti 1910, pra kanë 110 vjet që janë pjesë e kësaj konvente, kurse një grup tjetër i këtyre vendeve, sidomos ato të Afrikës Veriore, janë bërë pjesë e kësaj konvente në vitin 1966. Vendi ynë është i fundit në rajon që po bëhet pjesë e kësaj tryeze, ku do diskutohen problematikat shkencore. Po ashtu, kjo hapësirë do t'u shërbejë edhe liderëve politikë dhe administrativë për të diskutuar për atë çfarë ndodh në detin Mesdhe nga pikëpamja e ndryshimeve të mjedisit, që sot është bërë trendi i kohës.

A do të jemi ne të zotë që të absorbojmë më shumë para se sa të paguajmë? Siç e thashë, kjo tashmë ka ndodhur, sepse kjo konventë po mbështet disa projekte në vendin tonë, që kushtojnë më shumë se vlera e kostos që ne kemi të paraqitur.

Pse vendi ynë është i fundit që aderon në këtë konventë? Kjo besoj se ka ndodhur për disa faktorë, por, në radhë të parë, sepse asnjëherë ne nuk kemi menduar për detin. Janë pikërisht politikat e kësaj qeverie, që kërkojnë të zhvillohet ky dimension i turizmit detar, i cili ka të bëjë me shfrytëzimin e detit. Ne pothuajse nuk flasim fare për detin nga pikëpamja e ekonomisë dhe e turizmit dhe kemi sektorë me të ardhura pothuajse zero. Prandaj, edhe në kuadër të marrëdhënieve shumë të mira që kemi krijuar nëpërmjet politikave të Ministrisë së

Punëve të Jashtme me vendet e rajonit, do të kemi mundësi që të përfitojmë më shumë fonde nga kjo histori dhe të jemi pjesë e diskutimeve se çfarë ndodh në Mesdhe. Më kryesorja, siç e thashë, është që të krijojmë një atmosferë tjetër në Shqipëri për të folur për detin, sepse ne nuk flasim fare për turizmin detar. Kjo është një vërejtje nga pikëpamja e institucionit që unë drejtoj.

A do të ndikojë kjo për pjesën e detit Adriatik?-pyeti zonja Kodheli. Patjetër që do të ndikojë. Unë kam rënë dakord me kolegët e mi të Malit të Zi dhe të Kroacisë për të gjetur mënyra se si ta stopojmë keqmenaxhimin që po i bëjmë mbetjeve në vendin tonë, por për këtë duhet shumë punë, në mënyrë që të ndryshojmë mënyrën e menaxhimit të brendshëm të mbetjeve në Shqipëri.

Në vijim të përgjigjes së pyetjes së kolegut Bushati mund të them se Shqipëria nuk është e ndotur, por është papastër. Ky është fakt dhe për këtë temë ne mund të zhvillojmë edhe një seancë tjetër diskutimi në komisionin tuaj.

Shqipëria nuk është e ndotur, sepse nuk ka probleme me ndotjen. Pra, ne nuk ndotim, sepse ne nuk kemi industri, të cilat bëjnë ndotje të pariparueshme, ne prodhojmë energji bio; ne nuk kemi industri që ndotin ajrin; ne nuk kemi termocentrale me qymyr, siç ka Kosova; ne nuk kemi industri atomike, siç kanë vendet e tjera, por ne jemi të papastër, sepse i mbledhim mbetjet urbane në Shkodër, në Malësi të Madhe, në Pukë, në Fushë-Arrëz dhe i hedhim në lumin e Drinit dhe në lumin e Bunës dhe më pas këto mbetje përfundojnë në det.

(Diskutime pa mikrofon)

Ne po flasim për detin, sepse ende nuk kemi gurore në det, por i kemi pranë detit.

(Diskutime pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Ne i hedhim mbeturinat në lumë dhe lumi i sjell në bregun e detit.

(Diskutime pa mikrofon)

Blendi Klosi – Në datën 22 nëntor ne do të fillojmë një aksion vullnetar për pastrimin e Shqipërisë. Pra, meqenëse nuk jemi të ndotur, të mos jemi as të papastër. Unë i ftoj të gjithë kolegët deputetë që të bëhen pjesë e aksionit për të pastruar Shqipërinë në zonat ku ata zhvillojnë aktivitetin e tyre politik. Ky operacion do të zgjasë 6 muaj, me qëllim që sezoni i ardhshëm turistik ta gjejë Shqipërinë të pastër.

Një nga problemet më të mëdha që dua të zgjidhet, ku të gjithë deputetët mund të ndikojnë drejtpërsëdrejti te kryetarët e bashkive, është që të mos i përdorin më lumenjtë dhe bregun e detit si vende depozitimi natyror dhe legal të mbetjeve urbane. Ne mund ta pastrojmë shumë mirë qendrën e Tiranës, por në qoftë se Bashkia e Kamzës apo zona e Mëzez-it do t'i hedhin mbetjet në lumin Ishëm, në lumin Erzen apo në lumin e Tiranës, të

gjitha mbetjet do të dalin në sipërfaqe sa herë që të bjerë shi. Pra, qyteti mund të pastrohet shumë mirë, por, në qoftë se mbetjet e Dajtit apo Shëngjergjit nuk hidhen në lumë, por depozitohen në landfill-in e Sharrëz, Shqipëria do të jetë e pastër. Pra, Shqipëria nuk është e ndotur, por është e papastër dhe ky koncept i ri ka dalë tani, zoti Bushati.

(Diskutime pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Zonja Gjebrea, fjala për ju.

Elona Gjebrea - Faleminderit, zoti Ministër, për prezantimin e këtij projektligji!

Sigurisht, kjo është një arritje e madhe, duke pasur parasysh edhe të gjithë bashkëpunimin rajonal që ka vendi ynë në kuadër të kërkimit shkencor. Unë kam disa pyetje, por meqenëse jam biologe, do të më lejoni të them dy gjëra. Këtu thuhet se në këtë det do të kryhen hulumtime, studime, punë oqeanologjike. Ne do të paguajmë një detyrim, ndërkohë që ka edhe të deleguar kombëtar. A mund të na thoni diçka më shumë se nga cilat fusha janë nga janë përzgjedhur të deleguarit kombëtarë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, nuk janë përzgjedhur ende?

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk ka lidhje me mua kjo.

Në dijeninë time, dikur është mbështetur shumë dega e iktiologjisë, madje çdo vit kanë shkuar studiues jashtë shtetit pikërisht për këtë degë. Në vitet e fundit ka një mospëlqim të këtyre degëve, sepse, siç e dimë të gjithë, studentët zgjedhin ose degët e shkencave ekonomike ose shkencat juridike dhe nuk kanë tërheqje drejt shkencave natyrore. Kështu, ndoshta me anë të këtij projektligji ju mund të ndihmoni shumë studentë edhe për t'iu rizgjuar dëshirën për këto degë, pasi për kërkimin shkencor është shumë i rëndësishëm dhe vendi ynë ka mangësi të theksuara në këtë drejtim.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Blendi Klosi – Besoj se ju jeni e mirinformuar për... *(nuk dëgjohet)* dhe ju garantoj se ... *(nuk dëgjohet)*. Me aderimin e Shqipërisë si pjesë aktive në këtë konventë do t'ju kërkoj juve të më asistoni, që nëpërmjet Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe degës, ku ju keni njohuritë e nevojshme, të bëjmë një përzgjedhje nga vetë trupa pedagogjike për të qenë ata partnerët e drejtpërdrejtë të konventës për të bërë pjesën shkencore. Pra, do të jetë 100% përzgjedhje, ndjekje dhe përfitim i stafit pedagogjik të Universitetit të Shkencave të Natyrës.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Ministër!

Besoj se është momenti që ta hedhim në votim projektligjin.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin nën për nën.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

Suksese në punë, zoti Ministër!

MBYLLET MBLEDHJA